



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

29.05.2012

REAGIM - KOMERCIALIZUESI I NSH "FERMA E SHPEZTARISË" KA SHKELUR KONTRATËN

Prishtinë - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) reagon ndaj deklaratave të përfaqësuesve të ndërmarrjes "ADI", duke siguruar opinionin e gjerë se ish komercializuesit nuk iu është bërë e padrejtë nga AKP siç deklarohet, por ai ka bërë shkelje të kontratës së komercializimit dhe se nuk ka respektuar afatet e parapara përpara i përket periudhës së shfrytëzimit të ndërmarrjes dhe lirimit të saj.

Kontrata 10 vjeçare e komercializimit në mes ndërmarrjes "Adi" dhe UNMIK-ut, e nënshkruar me 02 korrik 2001 ka skaduar me 02 korrik 2011.

Kontrata e komercializimit ka paraparë kushte që duhet përmbushur nga "ADI"), e të cilat janë shkelur në vazhdimësi.

"ADI" ka pasur obligim të investoj në ndërmarrje shumë prej 2,190,885.70 euro, ndërsa, sipas auditimit të bërë nga Auditorët e Pavarur është konstatuar se ai ka bërë investime në shumë 441.943 euro, apo ka përmbushur kontratën 20.16 %.

"ADI" ka bërë shkelje të rëndë të kontratës përpara i përket pagesës së qirasë për shfrytëzimin e pasurisë së NSH "Ferma e Shpeztarisë". ADI, sipas Auditorëve të Pavarur, ka paguar në emër të të qirasë shumë 143.000 euro, ndërsa borxhi për qira i pashlyer është mbi 211.325 euro, apo shprehur në përqindje përmbushja është 40 %.

Edhe kushti tjetër i kontratës, ai i punësimit është shkelur nga komercializuesi. Sipas Auditorëve të Pavarur, ai kishte të punësuar nga 39 deri 58 punëtorë të rregullt, ndërsa obligim e kishte të punësoj 112 punëtorë.

Komercializuesi kishte marrë obligim me kontratë për ruajtjen e dokumenteve dhe dorëzimin e raporteve pranë AKP-së. Mirëpo AKP nuk ka pranuar asnjë raport për investime, punësim apo pagesë të qirasë rregullisht në baza kuartale që nga viti 2008.

Marrësi i kontratës së komercializimit (ADI), ka edhe obligime të pashlyera ndaj Administratës Tatimore të Kosovës.

"ADI" ka bërë marrëveshje me palë të tjera dhe ka lëshuar me qira objekte brenda ndërmarrjes pa lejen paraprake të AKP-së, edhe pse me kontratë ka qenë i obliguar të kërkoj leje.

Mosdorësimi i raporteve financiare, mospërmbushja e vlerës së investimeve të zotuar, mospagesa e qirasë, mospërmbushja e numrit të zotuar të punëtorëve, marrëveshjet me qiramarrës pa leje nga AKP si dhe mospagesave e taksave dhe tatimeve ndaj institucioneve përkatëse

Rr. Ilir Konushevc No.8,
10 000 Prishtina, Kosovë,
Tel: 038 500 400,
E-mail: info@pak-ks.org,
www.pak-ks.org



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

konsiderohen shkelje e kontratës së komercializimit. AKP vazhdimisht ka bërë vizita në ndërmarrje dhe e ka njoftuar komercializuesin me shkeljet e kontratës, duke kërkuar respektim të kontratës. Por nuk ka pasur përmirësim të gjendjes.

AKP, me vendim të Bordit të Drejtorëve të datës 29 prill 2010 i ka dhënë edhe gjashtë muaj afat shtesë komercializuesit. Që nga ajo kohë, komercializuesi vazhdimisht është njoftuar se duhet liruar ndërmarrja, madje Agjencia ka ushtruar edhe padi në gjykatat kompetente me qëllim lirim të pronave të ndërmarrjes.

Agjencia ka qenë e detyruar që të kërkoj ndihmë në organet policore në mënyrë që t'i mundësohet qasja në ndërmarrje shoqërore, pasi që është Agjencia ajo që administron me pronat e ndërmarrjeve shoqërore.

Nëse ish komercializuesi ka dëshmi për pretendimet e ngitura ndaj zyrtarëve të AKP-së, atëherë duhet drejtuar organeve kompetente të drejtësisë.

NSH Shpezëtaria i ka dy njësi të ndara: Shpezëtarinë në Dobratin dhe Peshkataria në Radevë.

Me qëllim të ruajtjes së fermës së pulave, njësia e Shpezëtarisë i është dhënë me qira kompanisë "Fidi" dhe kjo kompani zhvillon aktivitetin e saj në këtë hapësirë. Ndërsa njësia e Peshkatarisë në Radevë është nën menaxhimin e AKP-së, ku janë vendosur roje sigurimi.

AKP ka shqyrtuar mundësinë privatizimit të këtyre komplekseve sipas mandatit të saj dhe do të njoftoj opinionin për çdo vendim që ka të bëjë me të ardhmen e kësaj ndërmarrjeje shoqërore.

FUND